



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600090/10

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandohet zbatimi i pikës 24 të VKM Nr.618, datë 07.09.2006 nga administratori shoqëror i Bashkisë Lushnje për ti njoftuar qytetarëve datën e paraqitjes pranë KMCAP për të vlerësuar apo rivlerësuar aftësinë e tyre për punë*

Drejtuar: **Kryetarit të Bashkisë Lushnje**
Z. Fatos TUSHE

I nderuar Z. Tushe,

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me ankesën e të paraqiturit D. S., i cili pretendonte se po zvarritej procedura për rivlerësimin e aftësisë për punë. Më konkretisht ky i paraburgosur shpjegonte se, në Muajin Shtator 2015 kishte aplikuar për rivlerësim të aftësisë për punë duke plotësuar dokumentacionin e kërkuar që ishte dorëzuar në Bashkinë Lushnje. Bashkia Lushnje ia kishte përcjellë dokumentacionin KMCAP Fier por, në Paraburgimin në Rrugën "Jordan Misja" (313), Tiranë nuk kishte ardhur asnjë kërkesë për ekzaminimin e tij.

Për verifikimin e kësaj ankese fillimisht jemi interesuar pranë Shërbimit Social Shtetëror Fier, i cili na vuri në dijeni se për shtetasin D. S. i është dërguar lajmërim nëpërmjet listave përkatëse njësisë administrative të Bashkisë Lushnje Rj.4 për tu komisionuar pranë KMCAP Lushnje në datat 06.11.2015, 20.11.2015 dhe 04.12.2015. Referuar pikës 24 të VKM Nr.618, datë 07.09.2006, administratori shoqëror duhet të njoftonte këtë shtetas për datën e paraqitjes para komisionit.

Ndërsa sipas përgjigjes së Bashkisë Lushnje, ardhur me shkresën Nr.9815/1 Prot., datë 18.07.2016, është detyrë e Drejtorisë Rajonale të SHSSH Fier që të njoftojë DPBurgjeve për shoqërimin e të burgosurit në KMCAP.

Nga analiza në tërësi legjislacionin në fuqi rezulton se, detyra për ti njoftuar shtetasve datën e paraqitjes në KMCAP është e administratorit shoqëror të bashkisë. Në pikën 24 të VKM Nr.618, datë 07.09.2006 "*Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar*" përcaktohet se: "*Administratori shoqëror i bashkisë, çdo muaj, dërgon, me proceverbal, pranë mjekut të drejtorisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, listën e personave, që do të paraqiten a*

riparaqiten pranë KMCAP-it, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe njofton personat për datën e paraqitjes pranë këtyre komisioneve. Mjeku verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjellë ato në KMCAP.” Administratori shoqëror i Bashkisë Lushnje duhet të njoftonte IEVP-në ku ndodhej i paraburgosur shtetasi D. S. për të shoqëruar atë pranë KMCAP në datat e caktuara për tu komisionuar. Mosnjoftimi e ka privuar këtë shtetas nga mundësia për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar nga data aplikimit e deri më sot. Gjithashtu, ai është i detyruar të ndjekë procedurat e aplikimit për herë të parë në KMCAP, pasi nuk është paraqitur për rikontroll në datat e caktuara dhe gjatë tre muajve në vazhdim (pika 7 e Rregullores “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAP të invalidëve” të miratuar nga ISSH dhe Ministria e Shëndetësisë në datën 30.05.2005).

Gjykojmë se, ky rast duhet të merret në analizë nga Bashkia Lushnje dhe të merren masa që të respektohen kërkesat e legjislacionit në fuqi për njoftimin e shtetasve për data e komisionimit në KMCAP.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË:

Zbatimin e pikës 24 të VKM Nr.618, datë 07.09.2006 nga administratori shoqëror i Bashkisë Lushnje për ti njoftuar qytetarëve datën e paraqitjes pranë KMCAP për të vlerësuar dhe rivlerësuar aftësinë e tyre për punë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nein 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI